



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 12

Tiranë – E enjte, 7 shkurt 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 22, datë 7.2.2019	Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit..... 301
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 23, datë 7.2.2019	Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit..... 309

**VENDIM****Nr. 22, datë 7.2.2019****MBI MIRATIMIN E RREGULLORES
PËR KRITERET DHE PROCEDURËN E
FUNKSIONIMIT TË SKEMËS SË
DELEGIMIT TË GJYQTARIT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, i mbledhur sot më datë 7.2.2019, bazuar në nenin 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 dhe 89 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe nenit 45 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

VENDOSI :

1. Miratimin e “Rregullore për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimin.

2. Kjo rregullore hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

3. Çdo rregullim tjetër, që bie ndesh me rregullat e përcaktuara në këtë rregullore, shfuqizohet.

4. Të bëjë thirrje publike, për gjyqtarët që brenda tre ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të paraqesin kërkesat për kandidimin në skemën e delegimit. Njoftimi publikohet në faqen zyrtare të Këshillit dhe iu dërgohet kryetarëve të të gjitha gjykatave.

5. Për gjyqtarët që kanë aplikuar më parë në skemën e delegimit t’iu kërkohet që të rikonsiderojnë kërkesat e tyre në funksion të zbatimit të kësaj rregulloreje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami**

RREGULLORE**PËR KRITERET DHE PROCEDURËN E
FUNKSIONIMIT TË SKEMËS SË
DELEGIMIT TË GJYQTARIT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 2 dhe 89 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe nenit 45 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:**Neni 1****Objekti**

1. Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave të detajuara për kriteret dhe procedurën për funksionimin e skemës së delegimit dhe shërbimin në të sipas nenit 45 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 2**Subjektet**

1. Subjekte të kësaj rregulloreje janë gjyqtarët që ushtrojnë funksionin në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit të cilëve nuk u është kufizuar ushtrimi i funksionit për shkaqe të parashikuara në ligj.

Neni 3**Përkufizimet**

1. Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “Skema e delegimit” është tërësia e rregullave të komandimit të gjyqtarit, nga gjykata ku ai është i caktuar në mënyrë të përhershme, në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim Këshilli), për një periudhë kohore të caktuar dhe të shërbimit të tij në funksion të kësaj skeme, për të gjykuar çështje në çdo gjykatë.

b) “Delegim” është caktimi nga Këshilli i gjyqtarit në skemën e delegimit për gjykimin e çështjeve gjyqësore në gjykata.

c) “Dhënia e pëlqimit” është shprehja e vullnetit për t’u përfshirë në skemën e delegimit e dokumentuar me paraqitjen e deklaratës me shkrim sipas modelit bashkëlidhur kësaj rregulloreje.



ç) “Nevojat e gjykatës” nënkupton mungesën apo padisponueshmërinë ligjore të gjyqtarëve të një gjykate për gjykimin e një apo disa çështjeve ligjore.

Neni 4

Kriteret e kandidimit në skemën e delegimit

1. Në skemën e delegimit kandidon çdo gjyqtar që plotëson këto kriteret:

- a) të ketë dhënë pëlqimin për t’u komanduar në skemën e delegimit;
- b) të ketë jo më pak se 1 vit përvojë në funksion;
- c) të mos jetë nën efektet e një mase disiplinore, zbatimi i së cilës mund të shmanget për shkak të përfshirjes në skemën e delegimit;
- d) të mos ushtrojë funksionin e Kryetarit apo Zëvendëskryetarit;
- e) të mos jetë i caktuar në mënyrë të përhershme në një gjykatë ku komandimi cenon funksionalitetin e saj;
- f) të mos jetë duke ushtruar funksionin e tij si gjyqtar në një gjykatë tjetër për shkak të transferimit të përkohshëm me ose pa pëlqim.

Neni 5

Parimet e funksionimit të skemës së delegimit

1. Gjyqtari komandohet në skemën e delegimit për një periudhë kohe të miratuar nga Këshilli, por në çdo rast jo më pak se 6 muaj. Gjyqtari mund të komandohet në skemën e delegimit disa herë, me kusht që periudha totale e shërbimit të mos i kalojë 5 vjet.

2. Në përfundim të periudhës së komandimit gjyqtari rikthehet në pozicionin e mëparshëm.

3. Gjyqtari që shërben në skemën e delegimit mund të caktohet nga Këshilli të gjykojë çështje në çdo gjykatë përfshirë edhe gjykatën nga e cila vjen. Në pritje për t’u caktuar për gjykimin e një apo më shumë çështjeve, gjyqtari në skemën e delegimit shërben në strukturat administrative të Këshillit.

4. Caktimi i gjyqtarit të komanduar, për të gjykuar çështje, kryhet me short nga ana e Këshillit.

5. Pas komandimit në skemën e delegimit, gjyqtari përjashtohet nga shorti në gjykatën nga e cila vjen, por përfundon gjykimin e çështjeve në

shqyrtim.

6. Gjyqtari i cili shërben në skemën e delegimit raporton çdo muaj pranë Këshillit për mbarëvajtjen e punës.

Neni 6

Thirrja për kandidim

1. Gjyqtarët mund të shprehin interesin për t’u komanduar në skemën e delegimit duke kandiduar në çdo kohë. Kur Këshilli vëren se numri aktual i gjyqtarëve që shërbejnë në skemë është i pamjaftueshëm për t’u përgjigjur kërkesave të ardhura apo të pritshme për delegim, mund t’i ftojë gjyqtarët të kandidojnë për t’u bërë pjesë e skemës së delegimit.

2. Thirrja për kandidim bëhet publike në faqen zyrtare të Këshillit. Një kopje e njoftimit i dërgohet kryetarëve të të gjitha gjykatave.

Neni 7

Paraqitja dhe regjistrimi i kandidimit

1. Gjyqtari që kandidon paraqet dokumentacionin pranë Komisionit të Zhvillimit të Karrierës në Këshill, me anë të postës, postës elektronike ose dorazi.

2. Dokumentacioni regjistrohet dhe administrohet nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

3. Komisionit i Zhvillimit të Karrierës krijon dhe mirëmban një regjister të posaçëm për kandidaturat.

Neni 8

Verifikimi paraprak i plotësimit të kriterëve

1. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës verifikon paraprakisht plotësimin e kriterëve të kandidimit.

2. Komisioni i propozon Këshillit pranimin ose refuzimin e përfshirjes së gjyqtarit në skemën e delegimit.

Neni 9

Përfshirja e gjyqtarit në skemën e delegimit

1. Këshilli vendos për pranimin ose refuzimin e kandidaturës së gjyqtarit në skemën e delegimit mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

2. Vendimi për pranimin në skemën e delegimit përcakton afatin gjatë të cilit gjyqtari do të shërbejë në skemë. Ky afat do të përcaktohet



bazuar në nevojat e përcaktuara nga Këshilli.

3. Vendimi i Këshillit i njoftohet gjyqtarit përkatës sipas parashikimeve të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Një kopje e vendimit i dërgohet kryetarit të gjykatës.

Neni 10

Kërkesa për caktimin e gjyqtarit nga skema e delegimit

1. Kryetari i gjykatës në nevojë, i kërkon Këshillit caktimin e një gjyqtari nga skema e delegimit sipas modelit bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

2. Kërkesa paraqitet pranë Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe regjistrohet në një regjistër të veçantë që krijohet dhe administrohet nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Neni 11

Shqyrtimi paraprak i kërkesës për caktimin e një gjyqtari

1. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës shqyrton paraprakisht nëse kërkesa e kryetarit të gjykatës për caktimin e gjyqtarit identifikon qartë nevojën dhe plotëson kushtet formale për vazhdimin e trajtimit të saj.

2. Në rast se kërkesa për caktimin e një gjyqtari nuk plotëson kushtet formale, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i kërkon kryetarit të gjykatës plotësimin menjëherë të mangësive. Nëse mangësitë nuk plotësohen brenda 24 orëve nga momenti i njoftimit, Komisioni i propozon Këshillit refuzimin e kërkesës.

3. Në rast se kërkesa për caktimin e një gjyqtari nga skema e delegimit plotëson kushtet formale për vazhdimin e trajtimit të saj, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit pranimin e kërkesës.

4. Propozimi shoqërohet me listën e gjyqtarëve që janë pjesë e skemës së delegimit, duke evidentuar ata të cilët plotësojnë kriteret e vlerësimit sipas kësaj rregulloreje.

Neni 12

Kriteret e vlerësimit

1. Në varësi të kërkesës së gjykatës në nevojë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës harton një listë me gjyqtarët që janë pjesë e

skemës së delegimit, të cilët mund të përfshihen në short duke vlerësuar këto kriteret:

a) të plotësojnë kërkesat për pozicionin në gjykatën në nevojë;

b) të kenë përvojë profesionale sipas nevojës së evidentuar;

c) të kenë ngarkesë krahasimisht të përafërt me gjyqtarët e tjerë që shërbejnë në skemë;

ç) të caktohen në të njëjtën mënyrë në gjykatat më të largëta;

d) të caktohen për aq sa është e mundur brenda juridiksion territorial të gjykatës të apelit ku përfshihet gjykata nga vjen ose në një juridiksion territorial të afërt me të.

Neni 13

Procedura e shortit

1. Këshilli, brenda 3 ditëve nga marrja e kërkesës për caktimin e gjyqtarit nga skema e delegimit, zhvillon procedurën e shortit për përzgjedhjen në mënyrë rastësore të gjyqtarit.

2. Këshilli, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, miraton listën me emrat e gjyqtarëve nga skema e delegimit që përfshihen në short.

3. Shorti do të realizohet në rrugë elektronike e në mungesë të tij, shorti do të realizohet manualisht. Ky proces do të realizohet nga stafi ndihmës i Këshillit.

4. Shorti në mënyrë manuale do të zhvillohet sipas procedurës së mëposhtme:

a) emri i gjyqtarit shënohet në një shirit të barabartë letre, me germë *Times New Roman*, 14, **bold**.

b) nëpunësi i administratës verifikon saktësinë e shiritit dhe e palos në mënyrë të njëjtë duke e vendosur në kutinë përkatëse.

c) pas përzierjes së shiritave, nëpunësi lexon me zë të lartë emrin e gjyqtarit të përzgjedhur.

5. Në rastin kur në listën e delegimit ka vetëm një gjyqtar që plotëson kriteret për t'u caktuar, Këshilli vendos caktimin pa short të gjyqtarit.

6. Këshilli, në rast të një numri të lartë kërkesash për caktim gjyqtari, për aq sa është e mundur, i grupon ato duke u bazuar në gjykatën nga e cila vijnë dhe natyrën e çështjeve. Në këtë rast, shorti hidhet për të caktuar një gjyqtar për një grup çështjesh në të njëjtën gjykatë.



7. Vendimi i Këshillit u komunikohet gjykatave që kanë kërkuar caktimin e gjyqtarëve për të plotësuar trupën gjyqësore si edhe gjyqtarëve të përzgjedhur me short, menjëherë pas marrjes së tij.

Neni 14

Përfundimi i shërbimit në skemën e delegimit

1. Shërbimi në skemën e delegimit përfundon në afatin e caktuar në vendimin e Këshillit. Në këtë rast, gjyqtari kthehet automatikisht në gjykatën ku ka pasur emërimin pa pasur nevojën e një vendimi të ri të Këshillit.

2. Me vendim të Këshillit, koha e shërbimit në skemën e delegimit mund të përfundojë para afatit të përcaktuar:

a) në bazë të kërkesës së motivuar nga ana e gjyqtarit;

b) kur merret një masë disiplinore që e pengon pjesëmarrjen në skemën e delegimit;

c) kur verifikohet një rast i ndërprerjes së përkohshme të ushtrimit të funksionit të gjyqtarit.

3. Në këtë rast Këshilli mund të vendosë që gjyqtari të ndërpresë menjëherë gjykimin e çështjeve në shqyrtim.

4. Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar dhe me miratim të Këshillit, përfundimi i shërbimit mund të japë efekte përpara kohës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Neni 15

Përfitimet për shkak të pjesëmarrjes në skemën e delegimit

1. Gjyqtari që shërben në skemën e delegimit përfiton një kompensim sipas

parashikimeve të nenit 15 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në zbatim të nenit 15 të kësaj rregulloreje, Këshilli miraton rregulla të detajuara për kompensim, në konsultim me Ministrinë e Financës.

2. Përvoja si gjyqtar në skemën e delegimit konsiderohet një vlerë e shtuar për efekt të ngritjes paralele, ngritjes në detyrë dhe vlerësimit etik dhe profesional periodik të gjyqtarit.

Neni 16

Regjistri i skemës së delegimit

1. Këshilli me qëllim mirë administrimin e skemës së delegimit krijon një regjister të posaçëm i cili përmban informacion mbi gjyqtarët e përfshirë në skemë, kohën e tyre të shërbimit dhe ngarkesën e tyre.

Neni 17

Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

FORMULAR KANDIDIMI MBI PJESEMARRJEN NË SKEMËN E DELEGIMIT

TE DHENAT E GJYQTARIT

1. Emri: 2. Atësia: 3. Mbiemri:
4. Nr. Celulari: 5. E-mail:

GJYKATA KU GJYQTARI KA EMERIMIN

Shënim: Të plotësohet fusha ku gjyqtari ka emërimin

1. Gjykatë e shkallës së parë:
2. Gjykatë apeli:

TË DHËNA MBI VJETËRSINË

1. Vjetërsia në ushtrimin e detyrës:
2. Vjetërsia në gjykatën ku ushtron detyrën:

SEKSIONET/DHOMAT NË CILAT GJYQTARI KA BËRË PJESE

Shënim: Të plotësohet/n fusha/t ku gjyqtari ka bërë pjesë duke filluar nga momenti aktual

1. Seksioni/Dhoma: Vite:
2. Seksioni/Dhoma: Vite:



3. Seksioni/Dhoma: Vite:

4. Seksioni/Dhoma: Vite:

INFORMACION MBI MASAT DISIPLINORE

1. Masë disiplinore në fuqi: Po ☐ Jo ☐

Nëse po, specifiko llojin e masës dhe vitin kur është marrë kjo masë:

Unë , gjyqtar/e pranë Gjykatës
jap pëlqimin për të shërbyer në skemën e delegimit në çdo gjykatë të Republikës së Shqipërisë.

Nënshkrimi i gjyqtarit: Datë: / /

Ky formular është miratuar me vendimin nr. 22, 07.02.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.



Formular: KËRKESË– SKEMË DELEGIMI

FORMULAR përmbledhës kërkesë delegimi të gjyq pa shtojca (2/FINAL) (Read-Only) (Compatibility Mode) - Microsoft Word

File Home Insert Page Layout References Mailings Review View Acrobat

Clipboard Font Paragraph Styles

Times New Roman 11 A A

B I U X x² A

1 Normal 1 No Spacing Heading 1 Heading 2 Title Subtitle Subtitle Emphasis Intense Emphasis Strong Quote Intense Quote Subtle Reference Intense Reference Book Title

Find Replace Select Change Styles Editing

Formular: KËRKESË– SKEMË DELEGIMI

KËRKESË - SKEMË DELEGIMI

Ju lutemi plotësoni me "X" rubrikat. Nëse kërkohet, lutemi përshkruani.

Kërkesues: Gjykata	
Data e plotësimit të formularit	
Plotësuar nga Kryetari i Gjykatës (emri, mbiemri dhe nënshkrimi)	

Lista e çështjeve për të cilat kërkohet delegimi:

KATEGORIA	ÇËSHITJA	Arsyet e kërkesës				Shkalla e urgjencës ¹		
		1. Hapje dore: 2. Përpjekim 3. Për shkak të organizimit 4. Të tjera	Të për- urgjent ²	Urgjent ³	Normal ⁴			
A. Civile e përgjithshme								
1.								
2.								
3.								
4.								
B. Familjare / tregtare								
5.								
6.								
7.								
8.								
C. Penale								
1.								
2.								
3.								
4.								
D. Administrative (juridiksion i gjykatave administrative)								

¹ Nënshkrimi kërkon në dispozicion të gjykatës për shqyrtimin e çështjes në respektim të afatave ligjore

² Çështje gjyqësore për të cilat dispozitat procedurale parashikojnë të vendoset brenda 14 ditëve nga regjistrimi i çështjes në gjykatë (ligji 98-2016, neni 210)

³ Çështje gjyqësore për të cilat kërkohet shqyrtimi detyrë të përfundojë në kufirin e 60 ditëve

⁴ Çështje gjyqësore të cilat nuk klasifikohen as si "të për-urgjent" dhe as si "urgjent".

⁵ Lutemi sqaroni më në hollësi nëse ka ndodhur problematikë të veçantë që Këshilli Vëm të ndajë në vëmendje.

Page: 2 of 2 Words: 182 Albanian

Type here to search

3:12 PM 27/2019



FORMULAR për mbledhje të kërkesave të gjyqësorisë (2)(FINAL) [Read-Only] [Compatibility Mode] - Microsoft Word

File Home Insert Page Layout References Mailings Review View Acrobat

Clipboard Font Paragraph Styles

Times New Roman 11 A A

B I U L A A X X' A A

Format Painter

Clipboard Font Paragraph Styles

Normal No Spacing Heading 1 Heading 2 Title Subtitle Subtitle Emphasis Intense Emphasis Strong Quote Intense Quote Subtle Reference Intense Reference Book Title List Paragraph Footer Header

Formulari: KËRKESË - SKEMË DELEGIMI

KËRKESË - SKEMË DELEGIMI

Ju lutemi plotësoni me "X" rubrikat. Nëse kërkohet, lutemi përshkruani.

Kërkesues: Gjykata	
Data e plotësimit të formularit	
Plotësuar nga Kryetari i Gjykatës (emri, mbiemri dhe nënshkrimi)	

Lista e çështjeve për të cilat kërkohet delegimi:

KATEGORIA	ÇËSHTJA	Arsyet e kërkesës		Shkalla e urgjencës ¹	
		1. Hapje dore 2. Përgjithsim 3. Për shkak të organizimit 4. Të tjera	Tëparë urgjent ²	Urgjent ³	Normal ⁴
A. Civile e përgjithshme					
1.					
2.					
3.					
4.					
B. Familjare / tregtare					
5.					
6.					
7.					
8.					
C. Penale					
1.					
2.					
3.					
4.					
D. Administrative (juridiksion i gjykatave administrative)					

¹ Niveli i kohës në dispozicion të gjykatës për shqyrtimin e çështjes në respektim të afatave ligjore.

² Çështje gjyqësore, për të cilat dispozitat procedurale parashikojnë të vendoset brenda 14 ditëve nga regjistrimi i çështjes në gjykatë (Ligji 98-2016, neni 2-c).

³ Çështje gjyqësore për të cilat kërkohet shqyrtimi duhet të përfundojë në kushtin e 60 ditëve.

⁴ Çështje gjyqësore të cilat nuk klasifikohen as si "tëparë urgjente" dhe as si "urgjente".

Shënime:

1.

2.

3.

4.

5.

6.

7.

8.

9.

10.

11.

12.

13.

14.

15.

16.

17.

18.

19.

20.

21.

22.

23.

24.

25.

26.

27.

28.

29.

30.

31.

32.

33.

34.

35.

36.

37.

38.

39.

40.

41.

42.

43.

44.

45.

46.

47.

48.

49.

50.

51.

52.

53.

54.

55.

56.

57.

58.

59.

60.

61.

62.

63.

64.

65.

66.

67.

68.

69.

70.

71.

72.

73.

74.

75.

76.

77.

78.

79.

80.

81.

82.

83.

84.

85.

86.

87.

88.

89.

90.

91.

92.

93.

94.

95.

96.

97.

98.

99.

100.

101.

102.

103.

104.

105.

106.

107.

108.

109.

110.

111.

112.

113.

114.

115.

116.

117.

118.

119.

120.

121.

122.

123.

124.

125.

126.

127.

128.

129.

130.

131.

132.

133.

134.

135.

136.

137.

138.

139.

140.

141.

142.

143.

144.

145.

146.

147.

148.

149.

150.

151.

152.

153.

154.

155.

156.

157.

158.

159.

160.

161.

162.

163.

164.

165.

166.

167.

168.

169.

170.

171.

172.

173.

174.

175.

176.

177.

178.

179.

180.

181.

182.

183.

184.

185.

186.

187.

188.

189.

190.

191.

192.

193.

194.

195.

196.

197.

198.

199.

200.

201.

202.

203.

204.

205.

206.

207.

208.

209.

210.

211.

212.

213.

214.

215.

216.

217.

218.

219.

220.

221.

222.

223.

224.

225.

226.

227.

228.

229.

230.

231.

232.

233.

234.

235.

236.

237.

238.

239.

240.

241.

242.

243.

244.

245.

246.

247.

248.

249.

250.

251.

252.

253.

254.

255.

256.

257.

258.

259.

260.

261.

262.

263.

264.

265.

266.

267.

268.

269.

270.

271.

272.

273.

274.

275.

276.

277.

278.

279.

280.

281.

282.

283.

284.

285.

286.

287.

288.

289.

290.

291.

292.

293.

294.

295.

296.

297.

298.

299.

300.

301.

302.

303.

304.

305.

306.

307.

308.

309.

310.

311.

312.

313.

314.

315.

316.

317.

318.

319.

320.

321.

322.

323.

324.

325.

326.

327.

328.

329.

330.

331.

332.

333.

334.

335.

336.

337.

338.

339.

340.

341.

342.

343.

344.

345.

346.

347.

348.

349.

350.

351.

352.

353.

354.

355.

356.

357.

358.

359.

360.

361.

362.

363.

364.

365.

366.

367.

368.

369.

370.

371.

372.

373.

374.

375.

376.

377.

378.

379.

380.

381.

382.

383.

384.

385.

386.

387.

388.

389.

390.

391.

392.

393.

394.

395.

396.

397.

398.

399.

400.

401.

402.

403.

404.

405.

406.

407.

408.

409.

410.

411.

412.

413.

414.

415.

416.

417.

418.

419.

420.

421.

422.

423.

424.

425.

426.

427.

428.

429.

430.

431.

432.

433.

434.

435.

436.

437.

438.

439.

440.

441.

442.

443.

444.

445.

446.

447.

448.

449.

450.

451.

452.

453.

454.

455.

456.

457.

458.

459.

460.

461.

462.

463.

464.

465.

466.

467.

468.

469.

470.

471.

472.

473.

474.

475.

476.

477.

478.

479.

480.

481.

482.

483.

484.

485.

486.

487.

488.

489.

490.

491.

492.

493.

494.

495.

496.

497.

498.

499.

500.

501.

502.

503.

504.

505.

506.

507.

508.

509.

510.

511.

512.

513.

514.

515.

516.

517.

518.

519.

520.

521.

522.

523.

524.

525.

526.

527.

528.

529.

530.

531.

532.

533.

534.

535.

536.

537.

538.

539.

540.

541.

542.

543.

544.

545.

546.

547.

548.

549.

550.

551.

552.

553.

554.

555.

556.

557.

558.

559.

560.

561.

562.

563.

564.

565.

566.

567.

568.

569.

570.

571.

572.

573.

574.

575.

576.

577.

578.

579.

580.

581.

582.

583.

584.

585.

586.

587.

588.

589.

590.

591.

592.

593.

594.

595.

596.

597.

598.

599.

600.

601.

602.

603.

604.

605.

606.

607.

608.

609.

610.

611.

612.

613.

614.

615.

616.

617.

618.

619.

620.

621.

622.

623.

624.

625.

626.

627.

628.

629.

630.

631.

632.

633.

634.

635.

636.

637.

638.

639.

640.

641.

642.

643.

644.

645.

646.

647.

648.

649.

650.

651.

652.

653.

654.

655.

656.

657.

658.

659.

660.

661.

662.

663.

664.

665.

666.

667.

668.

669.

670.

671.

672.

673.

674.

675.

676.

677.

678.

679.

680.

681.

682.

683.

684.

685.

686.

687.

688.

689.

690.

691.

692.

693.

694.

695.

696.

697.

698.

699.

700.

701.

702.

703.

704.

705.

706.

707.

708.

709.

710.

711.

712.

713.

714.

715.

716.

717.

718.

719.

720.

721.

722.

723.

724.

725.

726.

727.

728.

729.

730.

731.

732.

733.

734.

735.

736.

737.

738.

739.

740.

741.

742.

743.

744.

745.

746.

747.

748.

749.

750.

751.

752.

753.

754.

755.

756.

757.

758.

759.

760.

761.

762.

763.

764.

765.

766.

767.

768.

769.

770.

771.

772.

773.

774.

775.

776.

777.

778.

779.

780.

781.

782.

783.

784.

785.

786.

787.

788.

789.

790.

791.

792.

793.

794.

795.

796.

797.

798.

799.

800.

801.

802.

803.

804.

805.

806.

807.

808.

809.

810.

811.

812.

813.

814.

815.

816.

817.

818.

819.

820.

821.

822.

823.

824.

825.

826.

827.

828.

829.

830.

831.

832.

833.

834.

835.

836.

837.

838.

839.

840.

841.

842.

843.

844.

845.

846.

847.

848.

849.

850.

851.

852.

853.

854.

855.

856.

857.

858.

859.

860.

861.

862.

863.

864.

865.

866.

867.

868.

869.

870.

871.

872.

873.

874.

875.

876.

877.

878.

879.

880.

881.

882.

883.

884.

885.

886.

887.

888.

889.

890.

891.

892.

893.

894.

895.

896.

897.

898.

899.

900.

901.

902.

903.

904.

905.

906.

907.

908.

909.

910.

911.

912.

913.

914.

915.

916.

917.

918.

919.

920.

921.

922.

923.

924.

925.

926.

927.

928.

929.

930.

931.

932.

933.

934.

935.

936.

937.

938.

939.

940.

941.

942.

943.

944.

945.

946.

947.

948.

949.

950.

951.

952.

953.

954.

955.

956.

957.

958.

959.

960.

961.

962.

963.

964.

965.

966.

967.

968.

969.

970.

971.

972.

973.

974.

975.

976.

977.

978.

979.

980.

981.

982.

983.

984.

985.

986.

987.

988.

989.

990.

991.

992.

993.

994.

995.

996.

997.

998.

999.

1000.

1001.

1002.

1003.

1004.

1005.

1006.

1007.

1008.

1009.

1010.

1011.

1012.

1013.

1014.

1015.

1016.

1017.

1018.

1019.

1020.

1021.

1022.

1023.

1024.

1025.

1026.

1027.

1028.

1029.

1030.

1031.

1032.

1033.

1034.

1035.

1036.

1037.

1038.

1039.

1040.

1041.

1042.

1043.

1044.

1045.

1046.

1047.

1048.

1049.

1050.

1051.

1052.

1053.

1054.

1055.

1056.

1057.

1058.

1059.

1060.

1061.

1062.

1063.

1064.

1065.

1066.

1067.

1068.

1069.

1070.

1071.

1072.

1073.

1074.

1075.

1076.

1077.

1078.

1079.

1080.

1081.

1082.

1083.

1084.

1085.

1086.

1087.

1088.

1089.

1090.

1091.

1092.

1093.

1094.

1095.

1096.

1097.

1098.

1099.

1100.

1101.

1102.

1103.

1104.

1105.

1106.

1107.

1108.

1109.

1110.

1111.

1112.

1113.

1114.

1115.

1116.

1117.

1118.

1119.

1120.

1121.

1122.

1123.

1124.

1125.

1126.

1127.

1128.

1129.

1130.

1131.

1132.

1133.

1134.

1135.

1136.

1137.

1138.

1139.

1140.

1141.

1142.

1143.

1144.

1145.

1146.

1147.

1148.

1149.

1150.

1151.

1152.

1153.

1154.

1155.

1156.

1157.

1158.

1159.

1160.

1161.

1162.

1163.

1164.

1165.

1166.

1167.

1168.

1169.

1170.

1171.

1172.

1173.

1174.

1175.

1176.

1177.

1178.

1179.

1180.

1181.

1182.

1183.

1184.

1185.

1186.

1187.

1188.

1189.

1

**VENDIM****Nr. 23, datë 7.2.2019**

**MBI MIRATIMIN E RREGULLORES
PËR KRITERET DHE PROCEDURËN E
TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM TË
GJYQTARIT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, i mbledhur sot më datë 7.2.2019, bazuar në nenin 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 dhe 89 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe nenit 46 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

VENDOSI :

1. Miratimin e “Rregullore për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit” sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimin.

2. Kjo rregullore hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

3. Çdo rregullim tjetër, që bie ndesh me rregullat e përcaktuara në këtë rregullore shfuqizohet.

4. Kthimin pa veprim të çdo pëlqimi të dhënë për transferim të përkohshëm nga gjyqtarët, të bëra para miratimit të kësaj rregullore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**KRYETARE****Naureda Llagami****RREGULLORE**

**MBI KRITERET DHE PROCEDURËN E
TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM TË
GJYQTARIT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 2 dhe 89 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe nenit 46 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:**Neni 1****Objekti**

1. Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kriterëve dhe procedurës së transferimit të përkohshëm të gjyqtarit sipas nenit 46 ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 2**Subjektet**

2. Subjekte të kësaj rregulloreje janë gjyqtarët që ushtrojnë funksionin e gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë dhe të apelit në Republikën e Shqipërisë të cilëve nuk u është kufizuar ushtrimi i funksionit për shkaqe të parashikuara në ligj.

Neni 3**Përkufizime**

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Gjykatë në nevojë” nënkupton gjykatën në të cilën ka një ose disa pozicione të lira të përkohshme, situatë e cila cenon funksionimin normal të saj.

b) “Pozicion i lirë i përkohshëm” nënkupton rastin kur gjyqtari që ka atë pozicion në mënyrë të përhershme, për të paktën 3 muaj, është përkohësisht në pamundësi për të ushtruar funksionin në atë pozicion.

c) “Pëlqim” është çdo shfaqje vullneti e materializuar e subjektit të kësaj rregulloreje, ku identifikohet pranimi i tij për transferimin e përkohshëm në një gjykatë të caktuar.

ç) “Transferim” është lëvizje e përkohshme e gjyqtarit për një periudhë të caktuar kohe, nga një pozicion i përhershëm në gjykatën e tij, në një pozicion të lirë të përkohshëm në një gjykatë tjetër të të njëjtit nivel ose të një niveli më të lartë nëse plotëson kriteret për atë pozicion.



d) “Mungesa e gjyqtarëve të disponueshëm në skemën e delegimit” nënkupton rastin kur në skemën e delegimit nuk ka gjyqtarë të caktuar apo kur gjyqtarët e caktuar janë në pamundësi ligjore për ushtrimin e funksionit.

dh) “Gjykatë me ngarkesë më të ulët” nënkupton gjykatën ku gjyqtarët kanë numrin më të ulët të çështjeve gjyqësore që kanë për shqyrtim në momentin e kërkuar kohor.

e) “Gjykata e tij apo gjykata nga vjen” nënkupton gjykatën kur gjyqtari është caktuar në mënyrë të përhershme.

Neni 4

Parimet e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit

1. Transferimi i përkohshëm i gjyqtarit kryhet vetëm kur nevoja e gjykatës nuk mund të plotësohet nëpërmjet skemës së delegimit.

2. Transferimi i përkohshëm i gjyqtarit kryhet vetëm atëherë kur në gjykatën në të cilën do të transferohet ka të paktën një pozicion të lirë të përkohshëm.

3. Transferimi i përkohshëm i gjyqtarit nuk kryhet nëse efekti negativ që shkakton në gjykatën e tij çmohet nga Këshilli se është më i madh se dobia që ai pritët të sjellë në gjykatën ku do të transferohet. Për këtë qëllim, Këshilli, në çdo rast, merr mendimin e kryetarit të gjykatës ku gjyqtari është i caktuar në mënyrë të përhershme.

4. Transferimi i përkohshëm bëhet ndërmjet gjyqtarëve nga gjykatat me ngarkesë më të ulët, duke filluar nga gjykatat më të afërta apo ato brenda të njëjtit juridiksion apelit me gjykatën në nevojë.

5. Në rast se ka më shumë se një gjyqtar që jep pëlqimin për transferim të përkohshëm në një gjykatë konkrete, Këshilli vendos të përzgjedhë atë kandidat që vjen nga gjykata me ngarkesën mesatare më të ulët për gjyqtar. Në rast se kandidatët vijnë nga e njëjta gjykatë, Këshilli përzgjedh kandidatin duke marrë në konsideratë përvojën profesionale të gjyqtarëve dhe fushën e së drejtës për të cilën kërkohet shërbimi i tij.

6. Në caktimin e periudhës së transferimit të përkohshëm, Këshilli mban parasysh mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor në tërësi, si dhe gjykatat mes të cilave ndodh transferimi në veçanti. Në çdo rast, periudha e transferimit në

kuptim të kësaj rregulloreje nuk mund të zgjasë më shumë se 1 (një) vit.

7. Transferimi i përkohshëm kryhet me pëlqimin e gjyqtarit që transferohet. Në rastin kur asnjë gjyqtar nuk jep pëlqimin, transferimi i përkohshëm mund të bëhet edhe pa pëlqim, sipas kriterëve të nenit 46/2 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

8. Në përfundim të periudhës së transferimit gjyqtari rikthehet në pozicionin e mëparshëm.

9. Transferimi i përkohshëm nuk bëhet në rastet kur gjyqtari është nën efektet e një mase disiplinore, zbatimi i së cilës mund të shmanget për shkak të përfshirjes në procedurën e transferimit.

KREU II

TRANSFERIMI ME PËLQIM

Neni 5

Shpallja e vendeve të lira për transferim të përkohshëm

1. Kur një gjykatë është në nevojë dhe në skemën e delegimit nuk ka gjyqtar të disponueshëm, Këshilli shpall pozicionin e lirë të përkohshme që është i hapur për transferim dhe u bën thirrje gjyqtarëve për të dhënë pëlqimin.

2. Këshilli shtyn shpalljen e vendeve të lira për transferim kur çmon se nevoja në gjykatën në të cilën synohet transferimi nuk është emergjente. Këshilli konsideron edhe marrjen e masave të tjera për adresimin e nevojës në gjykatën në të cilën synohet transferimi.

3. Këshilli autorizon Komisionin e Zhvillimit të Karrierës të ndjekë hapat e mëtejshëm për trajtimin e kërkesës për transferim.

Neni 6

Kërkimi i pëlqimit nga gjyqtari

1. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës identifikon gjykatat me ngarkesë më të ulët duke kërkuar informacion nga kryetarët e gjykatave të cilët e dërgojnë atë jo më vonë se dy ditë nga marrja e kërkesës.

2. Thirrja për aplikim publikohet në faqen e internetit të Këshillit dhe u komunikohet gjyqtarëve nëpërmjet kryetarëve të gjykatave.



Thirrja përmban kriteret e transferimit të përkohshëm sipas rastit në fjalë dhe modelin e dhënies së pëlqimit sipas modelit bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

Neni 7

Verifikimi paraprak i plotësimit të kriterëve

1. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës verifikon paraprakisht plotësimin e kriterëve të gjyqtarit që ka dhënë pëlqimin për transferim të përkohshëm.

2. Në rastet kur Komisioni i Zhvillimit të Karrierës konstaton se gjyqtari nuk plotëson kriteret e transferimit të përcaktuara në kërkesë, i propozon Këshillit refuzimin e kërkesës së tij për transferim.

Neni 8

Shqyrtimi i dhënies së pëlqimit për transferim të përkohshëm

1. Në vlerësimin e rasteve për transferim të përkohshëm, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, krahas verifikimit të plotësimit të kriterëve nga ana e gjyqtarit që ka dhënë pëlqimin, vlerëson edhe mendimin e kryetarit të gjykatës ku ushtron funksionet gjyqtari në fjalë.

2. Me kërkesë të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, kryetari i gjykatës dërgon me shkrim brenda dy ditësh mendimin e tij mbi transferimin e përkohshëm të gjyqtarit. Mendimi i kryetarit shpreh vlerësimin e tij mbi ngarkesën e gjykatës në tërësi dhe të gjyqtarit në veçanti, numrin total të gjyqtarëve që ushtrjnë funksionet në atë gjykatë, seksionin nga i cili vjen gjyqtari apo fushën e të drejtës në të cilën ai shërben, pasojat që mund të ketë në ngarkesën e gjykatës transferimi i gjyqtarit, si dhe një propozim mbi periudhën maksimale për të cilën gjyqtari mund të transferohet përkohësisht duke mbajtur në konsideratë efektet më të ulëta negative që mund të vijnë nga transferimi.

3. Në përfundim të shqyrtimit të rasteve të cilët kanë dhënë pëlqimin për transferim të përkohshëm Komisioni përgatit një raport për çdo rast dhe ia paraqet Këshillit për shqyrtim dhe vendim duke i propozuar:

- a) miratimin e transferimit të përkohshëm;
- b) refuzimin e transferimit të përkohshëm.

Neni 9

Vendimmarrja e Këshillit

1. Këshilli merr vendim për të transferuar ose jo përkohësisht gjyqtarin që ka dhënë pëlqimin pas shqyrtimit dhe propozimit të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës. Vendimi i komunikohet menjëherë gjyqtarit dhe kryetarëve të gjykatave.

2. Këshilli mund të vendosë që efektet e vendimit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit të fillojnë në një kohë më të mëvonshme nga data e vendimit.

KREU III

TRANSFERIMI PA PËLQIM

Neni 10

Fillimi i procedurës së transferimit të përkohshëm pa pëlqim

1. Kur nevojat e një gjykate për gjyqtarë nuk mund të plotësohen nga skema e delegimit dhe as nga transferimi i përkohshëm me pëlqim i ndonjë gjyqtari, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës njofton Këshillin dhe nis procedurat e transferimit të përkohshëm të një gjyqtari pa pëlqim.

Neni 11

Kushtet dhe kriteret e veçanta të transferimit pa pëlqim të gjyqtarit

1. Transferimi pa pëlqim bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të mëposhtme:

a) kur asnjë gjyqtar nuk jep pëlqimin për t'u transferuar përkohësisht në një gjykatë;

b) gjyqtari ose gjyqtarët duhet të jenë nga gjykatat me ngarkesën mesatare më të ulët për gjyqtar, të asaj shkalle për të cilën kërkohet transferimi;

c) gjyqtari duhet të jetë me përvojën më të pakët si gjyqtar në atë gjykatë;

d) gjyqtari duhet të përmbushë kriteret për pozicionin që kërkohet për t'u transferuar përkohësisht;

e) gjyqtari duhet të vijë nga gjykata e vendosur në të njëjtin juridiksion territorial të Gjykatës së Apelit, mundësisht të ndodhur sa më pranë gjykatës nga e cila vjen gjyqtari. Nëse gjykata më e afërt ndodhet në një juridiksion territorial të një gjykate tjetër apelit, gjyqtari



duhet të dërgohet nga kjo gjykatë. Në rast pamundësie, transferimi do të bëhet nga gjykata të tjera më të afërta.

2. Transferimi pa pëlqim për një periudhë të caktuar në gjykatat e apelit do të bëhet së pari nga gjyqtarët e apelit, sipas kriterëve të këtij neni. Në rast pamundësie, transferimi do të bëhet nga gjyqtarë të shkallës së parë që përmbushin kriteret për pozicionin që kërkohet për t'u transferuar përkohësisht.

3. Transferimi pa pëlqim për një periudhë të caktuar në gjykatën administrative, do të bëhet së pari nga gjyqtarët e gjykatave administrative, sipas kriterëve të këtij neni. Në rast pamundësie, transferimi do të bëhet nga gjyqtarët e gjykatave me juridiksion të përgjithshëm që përmbushin kriteret për pozicionin që kërkohet për t'u transferuar përkohësisht.

Neni 12

Identifikimi i gjyqtarit që do të transferohet pa pëlqim

1. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës shqyrton informacionin e mbledhur sipas nenit 6 për të përcaktuar gjykatën me ngarkesën më të ulët.

2. Pas përcaktimit të gjykatës me ngarkesën më të ulët, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës identifikon në atë gjykatë gjyqtarin me përvojën më të pakët i cili përmbush njëkohësisht edhe kriteret për pozicionin që kërkohet për t'u transferuar përkohësisht.

3. Në çdo rast, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson edhe mendimin e kryetarit të gjykatës ku ushtron funksionet gjyqtari në fjalë.

4. Kryetari i gjykatës dërgon me shkrim brenda dy ditësh mendimin e tij mbi transferimin e përkohshëm të gjyqtarit. Me kërkesë të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, kryetari i gjykatës dërgon me shkrim brenda dy ditësh mendimin e tij mbi transferimin e përkohshëm të gjyqtarit. Mendimi i kryetarit shpreh vlerësimin e tij mbi ngarkesën e gjykatës në tërësi dhe të gjyqtarit në veçanti, numrin total të gjyqtarëve që ushtrojnë funksionet në atë gjykatë, seksionin nga i cili vjen gjyqtari apo fushën e të drejtës në të cilën ai shërben, pasojat që mund të ketë në ngarkesën e gjykatës transferimi i gjyqtarit, si dhe një propozim mbi periudhën maksimale për të cilën gjyqtari mund të transferohet përkohësisht

Faqe | 312

duke mbajtur në konsideratë efektet më të ulëta negative që mund të vijnë nga transferimi. Mendimi i kryetarit të gjykatës nuk është përcaktues.

5. Në përfundim, Komisioni përgatit një raport për transferimin pa pëlqim dhe ia paraqet Këshillit për shqyrtim duke i propozuar miratimin e transferimit të përkohshëm dhe periudhën e transferimit.

Neni 13

Vendimarrja e Këshillit

1. Këshilli merr vendim për të transferuar ose jo përkohësisht pa pëlqim gjyqtarin pas shqyrtimit të propozimit të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës. Vendimi i komunikohet menjëherë gjyqtarit dhe kryetarëve të gjykatave mes të cilave ndodh transferimi.

2. Këshilli mund të vendosë që efektet e vendimit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit të fillojnë në një kohë më të mëvonshme nga data e vendimit.

3. Në rast se Këshilli vendos të mos miratojë propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, ky i fundit përsërit procedurën e parashikuar nga neni 12 i kësaj rregulloreje.

Neni 14

Përfitimet për shkak të transferimit të përkohshëm

1. Gjyqtari i cili transferohet përkohësisht sipas kësaj rregulloreje përfiton kompensim sipas parashikimeve të neneve 15/2 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 15

Regjistri i transferimeve

1. Këshilli krijon një regjister të posaçëm i cili përmban informacion mbi gjyqtarët e transferuar sipas kësaj rregulloreje, periudhën e transferimit dhe ngarkesën e tyre.

Neni 16

Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

**DEKLARATË****PËR****DHËNIE PËLQIMI PËR TRANSFERIM TË PËRKOHSHËM**

Unë _____, aktualisht gjyqtar/e pranë Gjykatës _____, me vullnetin tim të lirë, mbështetur në nenin 46 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, shpreh pëlqimin tim për transferimin e përkohshëm, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në Gjykatën _____, në të cilën evidentohet nevoja për krijimin/plotësimin e trupës gjyqësore në rastet konkrete.

DEKLARUESI

(_____)

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë